




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË –KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO POLJE



Ekstrakt nga procesverbali, mbledhja e shtatë - VII, e rregullt, e mbajtur më datë 31.07.2017, ora 10:00h, në Sallën e Kuvendit të Komunës.

Prezentë në mbledhje ishin anëtarët e Kuvendit të Komunës: Fadil Krasniqi - Kryesues i Kuvendit të Komunës, Qerim Gara - Zëvendëskryesues i Kuvendit të Komunës për Komunitete, Nazmi Kelmendi, Milaim Berjani, Remzi Shala, Bastri Sllamniku, Bedri Krasniqi, Sabit Bullatovci, Sabri Rexhepi, Shaban Ademi, Vjollca Konjusha, Mirishahe Berisha, Arjeta Jashari, Sazana Statovci, Naser Graiçevci, Ridvan Krasniqi, Fazile Sejdiu, Aida Alimi, Sabit Godeni, Migjen Kolshi, Hasan Krasniqi, Trandolina Duli, Ali Ismaili, Fitore Simnica, Ylber Islami, Elmi Shabani dhe Miroslav Veličković.

Kryetari i Komunës dhe Drejtorët e Drejtorive të Komunës: Jakup Dumani - Nënkryetar i Komunës, Halil Qerimi - Nënkryetar i Komunës për Komunitete, Nuriye Fazliu - Drejtore e Administratës, Ramadan Jashanica - Drejtor i Financave dhe Buxhetit, Abdullah Prebreza - Drejtor i Planifikimit Urban, Jakup Tërnavë - Drejtor i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës, Mimoza Kolshi - Drejtore e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Nuriye Avdiu - Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Maliq Berisha - Drejtor i Shërbimeve Publike dhe Mjedisit.

Të tjerë: Përfaqësuesit e KFOR-it dhe qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës përshëndeti të pranishmit në mbledhje, pas verifikimit të prezencës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës, konstatoi se ekziston kuorumi për mbajtjen e mbledhjes dhe prezantoi këtë:

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës 29.06.2017.
2. Pyetje dhe përgjigje parlamentare.
3. Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2016.
4. Shqyrtimi i parë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare'.
5. Shqyrtimi i dytë i 'Planit të Veprimit për kthimin e qëndrueshëm për personat e zhvendosur 2017-2018'.
6. Propozim për ndarjen e mjeteve financiare për mësimdhënës në Fushë-Kosovë.
7. Propozim për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme.
8. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës kërkoi nga anëtarët e Kuvendit të Komunës që të deklarohen për rendin e ditës së propozuar. Hap diskutimin.

Trandolina Duli: Para se të miratohet rendi i ditës unë e kam një reagim. Në mars të këtij viti Komuna e Fushë-Kosovës në Kuvendin Komunal e ka sjellë për miratim kërkesën për dhënien e pëlqimit për ndërtimin e objektit të shkollës fillore në Fushë-Kosovë me numër 301. Sipas propozimit të Ekzekutivit shkolla do të ndërtohej në hapësirën e blertë të 'Kompleksi 300' në lagjen 'Dardania', në një hapësirë prej 12.45 ari, me kapacitet prej 1000 nxënësve dhe do të ishte, siç përshkruhej, e tipit të mbyllur. Ne vazhdimisht kemi kërkuar ndërtimin e një shkolle të re, jo ashtu siç e ka sjellë Ekzekutivi, mirëpo të një shkolle e cila i plotëson nevojat dhe kërkesat e banorëve.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Gjatë propozimit të 'Rendit të ditës', ju mund të deklaroheni lidhur me këtë propozim, e jo për çështje tjera, pasi që në rend të ditës e kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' ku ju mund të bëni reagimet tuaja.

Trandolina Duli: Unë kam propozuar në Kuvendin Komunal që shkolla të ndërtohet në një parcelë adekuate. Po ashtu, kam propozuar që shkolla duhet të ketë kapacitet prej 2000 - 2500 nxënësve duke e marrë parasysh rritjen e vazhdueshme të banorëve që po ndodhë dita ditës në vendin tonë. Objekti shkollor i cili i plotëson kushtet për zhvillimin e procesit mësimor sipas standardeve duhet të ketë laboratorë, kabinete dhe një oborr të shkollës, ndërsa shkolla e cila ka filluar të ndërtohet është paraparë të jetë e tipit të mbyllur.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju lutem që të merrni fjalën atëherë kur keni për të propozuar ndonjë pikë të rendit të ditës, në mënyrë që mos të humbim kohë duke bërë komente për punët që tashmë janë kryer.

Naser Graiçevci: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ne jemi kundër këtij rendi të ditës. Arsyet tona dihen, pasi që, tash e një vit ne kemi kërkuar që në procedura të rregullta të futet një pikë e veçantë e rendit të ditës për 'Devijimet në qeverisjen komunale' dhe kjo gjë nuk ka ndodhë. Ne kemi plotësuar një kriter ligjor dhe kemi kërkuar një seancë të jashtëzakonshme. Unë ju informoj se kjo seancë do të mbahet prej datës 1 deri më 5 shtator, cilëndo nga këto data, dhe aty do të shfrytëzojmë të drejtën tonë ligjore dhe kushtetuese për të bërë një debat më të gjerë mbi këto çështje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne kemi biseduar për këtë çështje në Komitetin për Politikë e Financa. Është plotësuar kushti ligjor për të thirrur një Kuvend të jashtëzakonshëm, mirëpo pasi që gushti është muaji i pushimeve ne vendosëm që seanca të mbahet prej datës 1 deri më 5 shtator. Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim rendin e ditës së propozuar.

U votua me: shtatëmbëdhjetë vota 'për', shtatë 'kundër' dhe një abstenim; gjithsej njëzet e pesë (25) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi për shqyrtim rendin e ditës së propozuar.

Pika e parë (1) - Aprovimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e datës: 29.06.2017.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: E kemi për aprovim ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar e Kuvendit të Komunës, e mbajtur me datë 29.06.2017. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së propozojmë që të aprovohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e VI-të, e rregullt, e mbajtur me datën 29.06.2017, sepse konsiderojmë që i njëjti i përmban të gjitha diskutimet që kanë rrjedhë në mbledhje.

Trandolina Duli: Kjo është seanca e parafundit e kësaj legjislature katër vjeçare dhe qysh prej fillimit të këtij mandati unë vazhdimisht kam kërkuar që të respektohet Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Statuti i Komunës dhe Rregullorja e Punës së Kuvendit të Komunës të cilën e ka miratuar ky institucion. Mirëpo qysh prej mbledhjes së dytë unë e kam vërejtur se Komuna vazhdimisht ka bërë shkelje të këtyre ligjeve duke mos e bërë publikimin e audioincizimeve. Prandaj, unë edhe sot jam kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit dhe vazhdoj të jem prapa qëndrimit tim që ky institucion vazhdon të bëjë shkelje.

Ylber Islami: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Unë kam vërejtje sa i përket pikës së procesverbaleve, për shkak të mos publikimit të audioincizimeve të mbledhjeve për qytetarë. Prandaj, ky procesverbal është i papranueshëm. E keni detyrim ligjor, të cilin e keni aprovuar vetë në Statut, përmes të cilit qytetarët kanë të drejtë të kenë qasje në audioincizime.

Aida Alimi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ne jemi kundër aprovimit të ekstraktit të procesverbalit, për shkak të mos publikimit të audioincizimeve. Ju e dini që transparenca është kategori kushtetuese dhe qytetarët e Fushë-Kosovës kanë nevojë të dinë se çka flasin dhe çka mbrojnë këtu përfaqësuesit e tyre.

Pasi që diskutime dhe plotësime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për aprovimin e ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit të Komunës, e mbajtur më datë: 29.06.2017.

U votua me: gjashtëmbëdhjetë vota 'për', tetë 'kundër' dhe një abstenim; gjithsej njëzet e pesë (25) anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi ekstraktin e procesverbalit nga mbledhja e datës: 29.06.2017.

Pika e dytë (2) - Pyetje dhe përgjigje parlamentare.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: E kemi pikën 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare', ftoj anëtarët e Kuvendit të Komunës që ta marrin fjalën, nëse kanë pyetje të reja për Ekzekutivin e Komunës.

Fazile Sejdiu: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë e kam një ankesë nga qytetarët që banojnë në rrugën 'Hajrullah Zymi' në Fushë-Kosovë. Për shkak të ndërtimeve të larta që janë duke u zhvilluar në atë pjesë, në masë të madhe është dëmtuar rruga dhe trotuari. Për të dërguar një kabllo të rrymës deri tek banesat që po ndërtohen në një pjesë të madhe është demoluar rruga dhe më pas nuk është bërë riparimi i saj. Punëkryesi ka thënë që lejen e ka marrë nga Komuna, dhe unë desha të di a ka pasur Komuna ndonjë marrëveshje me punëkryesin, që pasi të përfundojnë

punimet ta kthejnë rrugën në gjendjen e mëparshme. Ankesa tjetër e qytetarëve është se janë vjedhur dy-tre kapakë të pusetave të kanalizimit dhe kjo gjë e ka vështirësuar qarkullimin e tyre me vetura.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kjo është një pyetje konkrete për Drejtorinë e Inspektoratit, të Shërbimeve Publike dhe Urbanizmit. Sepse, me të vërtetë, është e nevojshme që nëse ndodhin prishje të rrugëve gjatë procesit të kryerjes së punimeve nga kompanitë punëkryese, ato duhet të rikthehen në gjendjen e mëparshme dhe për këtë punëkryesi është i obliguar. Besoj se për këtë do të marrësh përgjigje adekuate.

Trandolina Duli: Pse nuk u ndërmor asgjë nga ky institucion në lidhje me banorët e fshatit Miradi e Poshtme të cilët në shenjë proteste e patën bllokuar rrugën në tetor të vitit të kaluar për të protestuar lidhur me eliminimin e rrezeve që ekzistojnë për shkak të mungesës së kalimeve të sigurt të rrugës për këmbësorët, ku në disa raste ka pasur edhe humbje jetësh. Pyetja tjetër është rrezikun që shkaktohet nga mungesa e laurave nga ku kryqëzohet autoudha me hekurudha. Fshatrat Bardh i Madh, Graboc i Poshtëm dhe Nakaradë janë vendet ku janë shënuar rastet më të shumta të aksidenteve. Pyetja ime është, çfarë hapash keni ndërmarr që të rregullohet kjo gjendje? Pyetja tjetër është lidhur me ndërtimin e shkollës së re e cila veçse ka filluar. A janë respektuar afatet ligjore për fillimin e ndërtimit të shkollës? A keni organizuar debat publik me banorët për t'i pyetur ata se a janë të pajtimit që t'iu zihet oborri dhe ata pak gjelbërim që ka mbetur prej të kaluarës? Me çfarë të drejte i keni ndërruar destinimin, këtu keni votuar që ndërtimi të bëhet para banesave, ndërsa punimet kanë filluar prapa banesave?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju e dini që ne e kemi aprovuar vetëm numrin e parcelës së përgjithshme për ndërtimin e shkollës dhe ata e kanë caktuar vendin ku është më i përshtatshëm, sepse as unë nuk do të votoja sikur shkolla të ndërtohej para banesave. Ndërsa sa i përket çështjes së laurave, kjo është kompetencë e kompanive publike Infrakos dhe Trainkos dhe nuk është kompetencë e Komunës. Mbikalimi në Graboc të Poshtëm është ilegal dhe është bërë pa miratimin e menaxhmentit të Hekurudhave të Kosovës. Për këtë arsye po të them që je e pa informuar për shumë gjëra.

Aida Alimi: Pasi që jemi tek pika "Pyetje dhe përgjigje parlamentare", kur do t'i marrim përgjigjet e gjithë atyre pyetjeve që i kemi bërë gjatë këtij mandati? Pyetja tjetër është: kur do të jenë funksionale komisionet që janë formuar në Kuvend?

Migjen Kolshi: Pyetja e parë është në lidhje me një kompani e cila e ka fituar tenderin në komunën tonë pa dashjen e Komunës. Komuna ka shpallur fitues një kompani tjetër, ndërsa OSHP-ja kompaninë në fjalë. Kjo kompani e cila bën hapjen e kanalizimeve ka dështuar të kryej punën e vet në disa raste, rasti konkret ka qenë në rrugën "Nënë Tereza" ku tri ditë kanalizimi ka mbetur i mbyllur dhe kjo kompani nuk ka qenë në gjendje ta hapë dhe ne e kemi thirrur një kompani tjetër - kolegun tonë, Sokol Duraku - i cili i ka sjellë makinat dhe e ka bërë hapjen. Desha të di se a ka bërë Komuna ndonjë ankesë lidhur me dështimin e kësaj kompanie? Pyetja e dytë, pse po bëhet dezinfektimi vetëm në qytet e jo edhe në fshatra? Dhe pyetja e tretë, a jeni të informuar që në lokalet të cilat janë 300 metra afër Komunës ushtrohet prostitucion? Desha të di a kanë leje të punës ato lokale, a kanë libereza të punës punëtorët si dhe a paguajnë tatim?

Drejtor i SHPM: Përshëndetje për të gjithë. Bashkë me ju edhe ne si Drejtori dhe Komunë ndajmë vazhdimisht shqetësimin për rastin e asaj kompanie. Prej ditës së parë jemi duke e përcjellë dhe organi mbikëqyrës çdo ditë i shkruan shkresa për t'i kryer punët. Ne e kemi të pamundshme të veprojmë, mirëpo detyra jonë është që të përcjellim punën e tyre dhe në rast të moskryerjes së punimeve, t'i dorëzojmë vërejtjet aty ku duhet në mënyrë që të vij deri të shkëputja e kontratës.

Sabit Godeni: Kam një pyetje lidhur me objektet publike të Komunës të cilat nuk po shfrytëzohen, siç është rasti me bibliotekën në fshatin Bardh i Madh, për të cilën ka kërkesa nga qytetarët që të merret me qira. Unë mendoj që është mirë që këto objekte të shfrytëzohen dhe jo të shkatërrohen duke mos u përdorur nga askush.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kam biseduar me Këshilltarin ligjor në lidhje me këtë çështje dhe ne nuk kemi të drejtë të marrim vendime në gjashtë mujorin e fundit të mandatit, ndërsa për publikime nuk e di a kemi të drejtë, mirëpo ne do ta shqyrtojmë këtë mundësi.

Ylber Islami: Sa është numri i të punësuarve në 'Caritas', a ka pasur proces të hapur publik dhe pjesëmarrje të barabartë të të gjithë qytetarëve siç e garanton edhe Kushtetuta. Auditimi ka qenë skandaloz, le që nuk janë plotësuar rekomandimet në organizimin e brendshëm të komiteteve, por as te ne si ekzekutiv asnjë shkronjë e atij raporti nuk është shtruar në debat, të cilën gjë e rekomandon edhe auditori i përgjithshëm. Për gurëthyesin në Nakaradë, së pari kam bërë kërkesë pastaj kam bërë edhe padi kundër jush dhe kundër ministrisë, të cilët kanë ardhur për të evidentuar gjendjen. Ata e kanë parë se nuk ka as leje pune as leje mjedisore. Komuna e Fushë-Kosovës është komuna me fshatrat më të ndotura në Evropë. Janë 10 tymtarë tash i shtohet edhe një gurëthyes kriminal. Qindra nënshkrime të atyre banorëve, pyetje, peticion dhe s'ka asnjë përgjigje, sepse asnjëra komunë nuk merr përgjegjësi. Nuk e di sa herë duhet të shtrohen këto pyetje. Mungon Kryetari, mungon Kryeinspektori, mungon Drejtori i Bujqësisë! Ku janë raportet financiare për Organizatat Jo Qeveritare. Ku po shkojnë investimet për bujqësi, kush i kontrollon ato? Si i lejohet Drejtorisë së Bujqësisë të formojë komisionin pa asnjë anëtarë të Kuvendit? A është publike kush janë anëtarët e Komisionit për Bujqësi? Të gjitha subvencionet që jepen nga drejtoritë së pari i marrin familjarët e tyre si dhe ata vetë e pastaj pjesa që mbetet për qytetarët.

Nazmi Kelmendi: Jemi në prag të kryerjes së mandatit, prandaj nuk do të duhej të keqpërdorej foltorja nga kolegët e mi. Ne kemi treguar një tolerancë të mirëfilltë, kemi shtjelluar të gjitha problemet, të cilat e kanë marrë fuqinë e votës ne suaza të rregulloreve, të Statutit, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale si dhe ligjeve përkatëse. Ju mund të vazhdoni të më incizoni sepse nuk frikësohem prej asaj çka unë flas këtu dhe kënd e përfaqësoj pasi që kam një pjekuri politike. Ne jemi të barabartë në shprehjen e mendimit dhe ju respektoj të gjithëve si kolegë. Për herë të parë kam dëgjuar që një person i cili ka mbetur i vetëm në një parti i thotë vetes 'Grup Parlamentar', megjithatë unë mendoj se duhet të respektohet edhe mendimi i kundërt. Nuk po themi që të gjitha çështjet janë në rregull, mirëpo mund të themi që ato janë të dëshirueshme dhe ne mund të japim kontributin tonë për përmirësimin e tyre, për çka edhe jemi të thirrur, gjithmonë duke respektuar ligjet në fuqi. Diskutimi im te komunitetet është keqpërdorur sepse delegacioni i 'Luginës' ka qenë vetë te Kryetari i Komunës dhe kanë pasur një pritje të përzemërt. Unë kërkoj nga Kryesuesi që të respektojmë rendin e ditës, rregulloren dhe të vazhdojmë tutje.

Trandolina Duli: Unë vazhdimisht kam thënë që nuk duhet të keqpërdoret foltorja, prandaj jam munduar që fjalimet e mia t'i sjellë në formë të shkruar në mënyrë që të jem sa më serioze para juve dhe para qytetarëve. Kemi disa përfaqësues që janë të pjekur politikisht, të cilët nuk e dinë Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, nuk e dinë kujt i takon Grupi Parlamentar, kujt i takojnë 15 minuta e kujt jo, prandaj edhe bëhen keqkuptime.

Remzi Shala: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Kam një pyetje për Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe Mjedisit, gjithashtu e përgëzoj për gatishmërinë për t'u përgjigjur në pyetjet tona në Kuvend. Në fshatin Henc është në përfundim e sipër ndërtimi i kanalizimit mirëpo gjatë punimeve janë dëmtuar disa hapësira. Çfarë mund të bëj komuna për përmirësimin e tyre? Desha të ndërlihem edhe me pyetjen e Migjenit lidhur me kompaninë për hapjen e kanalizimeve. Pasi që ka ankesa të shumta nga qytetarët për punët që kryen kjo kompani, është mirë t'i shfrytëzohen të gjitha mundësitë ligjore për t'i ndërprerë kontratën dhe t'i japim mundësinë kompanisë paraprake pasi që ka qenë shumë efikase në kryerjen e punëve. Dhe pyetja e fundit, a do të bëhet dezinfektimi edhe nëpër fshatra ose të paktën nëpër lagje të cilat janë afër disa prrockave?

Naser Graicevci: Kam një pyetje për Drejtorin e Bujqësisë. A është e vërtetë që përfitues të subvencioneve në Komunën tonë janë edhe qytetarët e komunave tjera? Unë kam dëgjuar për këtë çështje, mirëpo për të ditur vërtetësinë e saj kisha dashur të marr një përgjigje nga Drejtori i Bujqësisë?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Nëse do të kishte qenë pyetja konkrete do të bëhej më lehtë verifikimi, sesa kështu në këtë formë të përgjithshme. P.sh. nëse e tregoni emrin dhe mbiemrin e personit për të cilin keni dëgjuar se është përfitues i subvencionit.

Hasan Krasniqi: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. A mund të di mënyrën e funksionimit të klubeve sportive në Komunën tonë? Unë jam i informuar që klubet të cilat i shfrytëzojnë hapësirat e palestrave sportive në Gjimnazin "Hivzi Sylejmani" dhe në disa shkolla tjera obligohen të paguajnë qira. A keni njohuri për këtë gjë? Nuk e di kush i menaxhon hapësirat sportive në shkolla, mirëpo e di që një klub i Komunës sonë është detyruar që të paguajë qira për të shfrytëzuar një hapësirë të tillë.

Drejtores e KRS: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Para dy-tri seancave ju vetë keni votuar për propozimin që sallat sportive që janë nëpër shkolla të shfrytëzohen dhe menaxhohen nga shkollat, pa marrë parasysh që ato salla i ka ndërtuar Drejtoria për Rini, Kulturë dhe Sport. Megjithatë, të gjitha sallat që ekzistojnë në komunën tonë shfrytëzohen pa pagesë nga klubet, me përjashtim të disa rasteve kur sallat e shkollave shfrytëzohen pas orarit të punës dhe ndoshta ndonjë klub mund të ketë bërë pagesë për pastrimin e tyre.

Ali Ismaili: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Tek pika e rendit të ditës 'Pyetje dhe përgjigje parlamentare' mendoj se kemi dështuar. Si pozita po ashtu edhe opozita nuk kemi marrë përgjigje në 80% të rasteve, për të mos thënë që nuk kemi marrë kurrë. Nuk kam informacione të sigurt, mirëpo tek Sheshi "Nëna Terezë" në Prishtinë, afër Ministrisë së Kulturës, afërsisht rreth 2-3 javë kërkohet ndihmë për një djalosh të sëmurë, nga Fushë-Kosova, emri i të cilit është Ali Berisha. Desha të di se a është i paraqitur në Drejtorinë e Shëndetësisë ky rast? A është paraqitur në organet

e Komunës së Fushë Kosovës? Apo ndoshta do të duhej të interesoheshim edhe ne, bazuar në vullnetin e mirë, që të shohim mundësinë e Komunës sonë që t'i dalim në ndihmë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: Atëherë, ju ftoj që të interesoheni për këtë rast; le të vjen në Komunë, le ta sjell dokumentacionin e nevojshëm, le të dëshmon që është banor i Fushë Kosovës. Drejtoria për Shëndetësi është duke iu ndihmuar të gjithë atyre që kanë nevojë. Hulumtoje rastin dhe do ta shqyrtojmë, mund edhe të mos jetë banor i Fushë- Kosovës.

Pika e tretë (3) - Raporti i Auditimit të Jashtëm për vitin 2016

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Duhet ta dini që nëse Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) jep opinione pozitive për raportet financiare që janë përgatitur dhe dorëzuar nga institucionet qoftë publike, qoftë private, atëherë, realisht, për mua nëse raportet janë pozitive, atëherë nuk mund të kontestohet opinioni i tyre, sepse ZKA është agjenci e Parlamentit të Kosovës që është profesionale. Mirëpo, e kemi bërë të qartë që institucionet tjera duhet të merren me të metat që dalin nga raporti, qoftë prokuroria, qoftë organet e hetuesisë. Ne duhet të kërkojmë që të zbatohen rekomandimet të cilat i ka dhënë Zyra Kombëtare për Auditim.

Nazmi Kelmendi: Për çështjen në fjalë, Zyra Kombëtare për Auditim, i ka dhënë të gjitha vërejtjet, rekomandimet dhe opinionet. Opinioni është pozitiv dhe kërkohet që të bëhet plani i veprimit, sipas afatit të paraparë prej 30 ditësh, për zbatimin e të gjeturave sipas rekomandimeve nga raporti i auditimit në përputhje me legjislacionin. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë konfirmim për pajtueshmërinë dhe të gjeturat e përgjegjësive për çështje të cilat janë të rregulluara me ligj. Dhe sugjerojmë që në kuadër të saj të jetë edhe konkluzioni që të bëhet shqyrtimi i zbatimit të veprimeve të këtij plani në rekomandimet që i ka dhënë auditori lidhur me këtë çështje.

Ylber Islami: Vlerësimi i auditorit për mua është krejtësisht politik dhe jo profesional, ashtu siç është edhe vetë Auditori, i cili, paramendojeni i jep llogari Kuvendit të Kosovës. Kur i pata dhënë vërejtjet për raportin e kaluar, i cili ka qenë skandaloz dhe i kualifikuar, Kryesuesi dhe të tjerët patën thënë që nuk i besojmë atij auditimi. Ndërsa tani kur raporti del në rregull ata thonë që ky auditim është organ zyrtar i shtetit. Ju po e demantoni vetveten për këtë arsye nuk po i lejoni audioincizimet për qytetarë. E kemi në rend të ditës 'Raportin e Auditimit', ndërsa Drejtori i Auditimit mungon. Për shpërdorimin e 345,000.00€ auditori përdorë shprehje të buta duke thënë se është si pasojë e keqklasifikimit, e keqplanifikimit, e keqmenaxhimit mirëpo unë mendoj se ky është krim i pastër ekonomik, financiar. Vlera prej 140,000.00€ e destinuar për bashkëfinancim të investimeve kapitale ishte paguar për subvencionimin e bujqve, si: plehra, kultivatorë, koshere të bletëve etj. Shpenzimet në vlerë prej 180,000.00€ për projektin për mirëmbajtje, pastrimi i ambientit, ngritja e kujdesit social shëndetësor, shtëpiak, ambulantor që janë aprovuar për investime kapitale, kanë kaluar për shërbime të përkujdesit social shëndetësor. Për të gjitha këto manipulime është përgjegjës pushteti. Çfarë ka ndodhë me auditimin e kaluar i cili doli i kualifikuar. Ju e dini kuptimin e procedurave formale dhe mënyrën si bëhet auditimi. Auditorët kanë banesa në Fushë-Kosovë dhe kjo është edhe një arsye më shumë që unë të mos i besoj këtij raportit. Vitin e kaluar ndoshta edhe për shkak të ndërrimit të auditorit të përgjithshëm është bërë një vendim real. Ndërsa për raportin që e kemi marrë tani nuk po merr përgjegjësi askush. Në

krahasim me 340,000.00€ keqmenaxhim, keqkualifikim, ndërrim i tërësishëm i kodeve shumat prej 5,000.00€, 2,000.00€ janë cikërrime.

Trandolina Duli: Me aq sa kam parë, raporti i auditimit të jashtëm është material për prokurorinë. Besoj se auditori, për hir të respektit institucional, ka përdorur shprehje më të buta në raport. Unë do t'i lexoj një nga një problemet që i ka theksuar auditori, më saktësisht, disa prej tyre, duke e dhënë edhe mendimin tim lidhur me këtë raport. Në njërën prej citateve auditori thotë: prej mostrave të testuara kemi vërejtur se janë bërë financime nga kategoria e investimeve kapitale në mallra dhe shërbime si dhe në subvencione në shumën totale prej 345,755.00€. Arsyeja e keqklasifikimit ishte planifikimi jo i mirë i buxhetit nëpër kategoritë ekonomike. Vlen të sqarohet se vlera prej 140,842.00€ e destinuar për bashkëfinancim të investimeve kapitale ishte paguar për subvencionimin e bujqëve, si: plehra, kultivatorë, koshere të bletëve etj. Ndërsa vlera prej 182,818.00€ është paguar për projektin e mirëmbajtjes dhe pastrimit të ambientit, ngritjes së kujdesit social shëndetësor, shtëpiak, ambulantor. Pse ndodhë kjo: keqplanifikimi i buxhetit, mungesa e profesionalizmit dhe besa edhe manipulimet me shifra. Në raportin e auditimit thuhet se gjysma e rekomandimeve të vitit të kaluar nuk janë zbatuar për shkakun se Komuna nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të menaxhuar dhe monitoruar veprimet e zbatimit të rekomandimeve të Auditorit të Përgjithshëm. Pse ndodhë kjo: sepse për t'i marrë parasysh rekomandimet e Auditorit duhet me qenë profesionist në rend të parë, dhe e dyta, duhet me i ndalë dallaveret dhe keqpërdorimet. Citati i 3-të, rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin financiar të Komunës kanë gjetur dobësi në nivelet e kontrolleve. Kjo ndodhë sepse nuk ka kontroll, sepse kontrolli nënkupton moslënien e hapësirës për keqpërdorime. Me rastin e dhënies së lejes së ndërtimit për një objekt kishte pasur vonesë me pajisjen me leje më gjatë se 30 respektivisht 45 ditë nga aplikimi sipas ligjit për ndërtime Nr. 04/LI 10. Kërkesa për aplikim ishte bërë më 23.03.2014, ndërkaq leja e ndërtimit është dhënë pas dy viteve, më 20.07.2016. Deri këtu nuk është shumë tragjike, mirëpo të ndërtohet objekti ende pa e marrë lejen, dhe të lëshohet leja pas dy vitesh atëherë kur objekti veçse është ndërtuar, kjo padyshim, që është material për prokurori. Komuna për vitin 2016 ka planifikuar 555.000,00€ ndërsa ka faturuar 649.480,00€. Deri më 31.12.2016 Komuna ka inkasuar 616.000,00€, kjo tregon se kishte shpërputhje të mëdha në mes të planifikimit për të hyrat nga tatimi në pronë, faturimit dhe shkallës së inkasimit. Pse ndodhë kjo: Kur ne ju kemi akuzuar për mospërputhje të planifikimit për të hyrat vetanake në raportet paraprake lidhur me inkasimin, ju keni thënë, se ky është sukses sepse ne e kemi tejkaluar planifikimin, kemi mbledhur më shumë se sa kanë qenë të planifikuara.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ti e din që janë falur borxhet, për këtë arsye ka shpërputhje, sepse arkëtimi ka ardhur më i madh se sa planifikimi. Ju nuk keni të drejtë absolutisht.

Trandolina Duli: Sikur fjalimet e mia, pyetjet dhe përgjigjet parlamentare që kam shtruar të kishin gjetur vëmendjen e duhur, atëherë do ta mirëprisja një përgjigje, qoftë prej drejtorit, qoftë prej personit përkatës. Ka edhe shumë pika tjera që i përmban ky raport që janë shkelje ligjore, por duke e ditur që gjithmonë hasim në vesh të shurdhër, atëherë është vetëm humbje e energjisë.

Naser Graicevci: Ne kemi dy qëndrime lidhur me Raportin e Auditimit të Jashtëm. E para, raporti është shumë i cekët, jo një auditim i thelluar për të na dhënë një pasqyrë më reale të zhvillimit

përgjatë vitit 2016, dhe e dyta, edhe në këtë raport ekzistues në të gjitha mostrat që auditori ka marrë ka gjetur shkelje edhe mangësi të qeverisjes në Komunë. Ne kemi parë që vetë raporti e citon si prioritet të lartë klasifikimin e kodeve që është një vlerë bukur e madhe prej 345,755.00€ mijë euro, të cilat janë të parapara për investime kapitale dhe ato shndërrohen për mallra dhe shërbime. Ata që i njohin investimet kapitale e dinë që ato kanë të bëjnë me vlerën e shtuar të atyre parave të cilat si para publike derdhen në projekte kapitale dhe kjo mbetet edhe për gjeneratat e ardhshme. Mallrat dhe shërbimet janë kategori që shpenzohen aty për aty, normalisht, edhe ato u dedikohen qytetarëve por nuk janë diçka që krijon vlerë të shtuar. Prandaj, është shqetësuese kjo mënyrë e trajtimit, klasifikimi i kodeve. Po ashtu, është shumë brengosëse mos përcjellja e rekomandimeve të raportit të auditimit nga viti i kaluar. Komuna thotë se ka plotësuar vetëm dy nga tetë rekomandime, gjashtë janë të pa-plotësuara edhe kjo është shqetësuese për neve dhe për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Vërejtje tjetër që ka të bëjë me logjikën e veprimit apo veprimin e logjikës, nga strategjia, dizajnimi apo konvertimi në plane operative. Komuna nuk i bën këto, ka një strategji në letër dhe ka plane tjera të cilat absolutisht nganjëherë dalin nga ajo strategji. Pse hartojmë strategji të gjithë e dimë; strategjia ka një mision, një vizion se ku dëshirojmë të arrijmë, dhe nëse ne nuk e përfillim atë strategji, atëherë kemi bërë një dokument i cili qëndron në sirtar apo në arkivin e Komunës sa për të thënë se e kemi bërë, ndërsa planet operative janë krejt tjera. Kjo është e papranueshme. Komuna paguan dy auditorë të brendshëm, të cilët, ose janë në shërbim të Komunës, gjegjësisht ekzekutivit, ose janë joprofesional dhe nuk e dinë se çka duhet të bëjnë, prandaj për çdo vit auditimi i brendshëm është pika më e zezë në këtë Komunë. Raportet e auditimit të brendshëm janë esenciale për mbarëvajtjen dhe shpenzimin e parasë publike. Qëllimi i auditimit të brendshëm është që t'i udhëzojë drejtorët që të mos gabojnë rreth procedurave, kështu që në mungesë të tij drejtoritë e caktuara, dikasteret e caktuar të qeverisjes lokale sigurisht që kanë mundësi të bëjnë gabime. Nëse nuk kemi raport të tillë të auditorit të brendshëm është brengosëse që këto paga të majme që i marrin këta dy zotërinj të mos i arsyetojnë me veprimet e veta. Për mos shpenzimin e buxhetit sidomos në investime kapitale ne kemi thënë edhe më parë që kjo është për t'u brengosur. Investimet kapitale shfrytëzohen vetëm 62%, kjo është shumë brengosëse për një Komunë me gjithë këto nevoja dhe këto kërkesa, me gjithë këtë kaos urbanistik. Ne nuk kemi marrë asnjë përgjigje këto 4 vite, për mos arkëtimin e taksave nga veprimtaritë biznesore që ka shkuar në 800 mijë euro. Kjo është një shumë e madhe me të cilën mund të bëjmë mrekulli e jo të keqpërdoret popullata në këtë nivel. Ky adresim i auditorit të përgjithshëm është adresim i përvitshëm, mirëpo Komuna me apo pa qëllim, me apo pa dëshirë edhe pas të gjitha vërejtjeve në raportin e auditimit e ka lejuar këtë mos arkëtim të shumave të mjeteve. Ne si opozitë kemi vetëm këtë kualifikim se komuna me qëllime të caktuara bënë favore të caktuara ndaj bizneseve për blerjen e votës. Asnjëherë nga ekzekutivi nuk kemi marrë një përgjigje konkrete që do të tregonte se ky mos arkëtim ka ndodhë për këtë çështje. Do të ishte mirë që ekzekutivi të shikonte se cilat prona komunale janë pa kontrata, të trajtohet ky problem në mënyrë që raporti i ardhshëm mos të na vijë me çështje të tilla. Është qesharake që auditori ndalet në dy pagesa, 1.000,00€ dhe 1.712,00€, d.m.th. që krejt është në rregull vetëm këto dy pagesa i keni bërë në mënyrë të

paligjshme. Çmimi prej 1.000,00€ që ja paskan dhënë një eksperti ka mundur të jetë 999,00€. Për këto arsye ne do të jemi kundër këtij raporti auditues.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ju e dini që ne nuk e votojmë këtë raport, por vetëm i sugjerojmë ekzekutivit që në afatin ligjor ta përgatisin planin e veprimit dhe të bëjnë eliminimin e të gjitha të gjeturave në raport të rekomanduara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Pika e katërt (4) - Shqyrtimi i parë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi në shqyrtimin e parë 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare', ftoj Drejtoreshën e Shëndetësisë që të na jap sqarime.

Drejtoresha e SHMS: Përhëndetje për të gjithë. Desha të bëjë disa sqarime të shkurta rreth këtij Statuti që sot do të dal në shqyrtimin e parë, ndërsa në mbledhjen e fundit para shtatorit do të dal në shqyrtimin përfundimtar. Ne kemi arritur në një fazë ku për avancimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore duhet të bëjmë disa ndryshime. Ka pasur reagime të ndryshme si dhe ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila, është hedhur poshtë, prandaj edhe është zgjidhur aprovimi i këtij Statuti prej vitit 2014. Motivet dhe ankesat kanë qenë nga më të ndryshmet, duke filluar prej atyre që sinjorisht janë brengosur apo kanë pasur shqetësime lidhur me qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore, deri në ato krejt personale. Në mbledhjen e Komitetit për Politikë e Financa janë shfaqur disa shqetësime rreth emërimit të QKMF-së. Lidhur me emërtimin e QKMF-së nuk ka qenë QKMF-ja ajo e cila ka kërkuar apo lejuar ndryshimet e Statutit të QKMF-së, është grupi punues ai i cili e ka dhënë propozimin. Askush në QKMF nuk e ka kundërshtuar përfshirjen e emrit të dr. Fatmir Krasniqit në emërtimin e QKMF-së, përkundrazi ne jemi krenar për këtë emër.

Fazile Sejdiu: Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës 'Shqyrtimi i parë i 'Projekt-Statutit të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare', ne si grup parlamentar propozojmë që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. Po i jap disa sqarime për arsyeshmëri. Ky projekt-statut ka ardhur për miratim prej vitit 2015 dhe asnjëherë nuk ka dal për shqyrtim në Kuvendin e Komunës që ne ti japim propozimet tona. Drejtoresha i tregoi arsyet pse ka ndodhë kjo gjë. Problemi tjetër është se këshilltarëve komunal nuk ju ka ardhur projekt-statuti i hartuar nga Ministria e Shëndetësisë në mënyrë që të shohim ku janë bërë ndryshime në këtë statut si dhe a është përshtat ai për komunën tonë. Dhe e treta është Komiteti për Shëndetësi, i cili edhe është formuar me vonesë. Njëra prej kompetencave të Komitetit për Shëndetësi është që të jenë vëzhgues kur bëhet ndarja e subvencioneve për shëndetësi, mirëpo asnjëherë ky komiteti nuk është thirrur kur janë bërë ndarjet e subvencioneve. Kompetencë tjetër e Komitetit për Shëndetësi është që të jenë pjesëmarrës në hartimin e statutit të QKMF-së. Nuk e di qysh del për shqyrtim, shqyrtimin e parë, Projekt-Statuti kur nuk janë thirrur profesionistët, të cilët, janë përfaqësues të popullit dhe janë për çdo ditë në rrjedha të punës dhe problemeve të shëndetësisë në Komunën e Fushë-Kosovës. A ka përputhshmëri ky Statut të cilin e ka hartuar Këshilli Drejtues me projekt-statutin që vjen prej ministrisë. Prandaj kërkojmë që të shtyhet kjo pikë e rendit të ditës, kur ka pritur dy vjet, le të pres edhe një muaj, t'iu sillat këshilltarëve projekt-statuti, të thirret Komiteti për Shëndetësi, të thirret Këshilli Drejtues dhe në bashkëpunim të bëjmë hartimin dhe fillojnë procedurat për daljen në shqyrtim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Ne kemi formuar një Komitet në nivel të Kuvendit Komunal, le të angazhohet ky Komitet për këtë çështje. Ju duhet ta keni të qartë që ky është shqyrtimi i parë, nuk po aprovohet Statuti, mirëpo po del në diskutim publik, kështu që le t'i japin vërejtjet të gjithë. Megjithatë ky Statut duhet me qenë në pajtueshmëri të plotë me Statutin që ka sjellë Ministria e Shëndetësisë, sepse ky Statut është unik për gjithë Republikën e Kosovës dhe nuk guxojmë të bëjmë ndryshime ashtu siç mendoni ju.

Fazile Sejdiu: Çfarë do të ndodhte sikur ndonjëri prej këshilltarëve komunal e ngrit dorën dhe e aprovon që të vazhdohet procedura kur nuk është thirrur Komiteti për Shëndetësi?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Le të thirret Komiteti për Shëndetësi edhe Këshilli Drejtues dhe të vazhdojnë punën e vetë. Ky është vetëm diskutim publik, askush nuk po ua mohon të drejtën tuaj. Para se të aprovohet ky Statut ju i sillni vërejtjet tuaja me shkrim dhe i shqyrtojmë së bashku. Ne nuk mund të vonohemi më, e përmendi edhe Drejtoresha që këtë Statut e ka kundërshtuar edhe Asociacioni i Komunave të Kosovës, ka pasur ankesë në Gjykatën Kushtetuese, e cila është kthyer pozitive pasi që Ministria e Shëndetësisë ka pasur të drejtë dhe për këtë arsye ne nuk duhet ta shtyjmë këtë punë më shumë. Unë e kam dhënë vërejtjen edhe në Komitetin për Politikë e Financa, se është dashur që Statuti të sillet me preambulë dhe me forma të cilat i përgjigjen Fushë-Kosovës, e jo Ministrisë së Shëndetësisë. Sepse, ne nuk mund të aprovojmë një punë të cilën më parë e ka aprovuar Ministria, por vetëm ta përshtatim, do të thotë ta përshtatim Statutin që i përgjigjet Komunës së Fushë-Kosovës, e jo t'i ndryshojmë kompetencat edhe kriteret që janë në atë Statut. Për këtë arsye po them që nuk ka nevojë të ndalet kjo pikë e rendit të ditës. Të aktivizohet Komiteti për Shëndetësi dhe të punojë në lidhje me Statutin i cili do të vjen në aprovim në muajin shtator, tetor apo kur do që të jetë gati. Nëse nuk është gati ne nuk mund ta qesim si pikë në rend dite, atëherë kjo pikë mbetet në mandatin tjetër.

Drejtoresha e SHMS: Në Statut nuk është bërë asnjë ndryshim, është origjinali që ka ardhur nga Ministria e Shëndetësisë. Për çdo ndryshim që duam të bëjmë ne ose ju, duhet t'i bëjmë propozim Ministrisë së Shëndetësisë si dhe duhet të marrim miratimin e tyre. Ndërsa, sa i përket pyetjes për komisione, ne e kemi komisionin e subvencioneve në nivel komunal.

Nazmi Kelmendi: Unë mendoj se është fat i mirë që ky shqyrtim ka ardhur në rend të ditës pas gjithë kësaj vonese dhe pritjeje. Kjo ka qenë një iniciativë e kahershme për t'u punuar ku është bërë një version për ndryshime dhe plotësime rreth Statutit të QKMF-së 'Dr. Fatmir Krasniqi' në Fushë-Kosovë. Unë besoj se ky Kuvend është njëri prej Kuvendeve i cili ka në përbërjen e tij më së shumti kuadro me mjek dhe me staf përkatës të shëndetësisë, të cilët, shpresoj se do të japin kontribut të mirëfilltë që kjo çështje të shkojë aty ku duhet. Po ashtu besoj që do të respektojmë procedurat që janë të rregulluara me ligj edhe për funksionalizimin e komisionit, të cilin askush nuk e mohon, edhe për harmonizimin dhe miratimin e Statutit i cili është unik për gjithë Republikën e Kosovës. Ne shpresojmë që në nenin 1 të preambulës të këtij Statuti të ardhshëm të figurojë emri i mirënjohur i doktorit tonë Dr. Fatmir Krasniqi. Ne si grup parlamentar propozojmë që të fillojnë procedurat sipas propozuesit dhe ne të japim kontributin tonë.

Remzi Shala: Për fat të mirë anëtarët e Komitetit për Shëndetësi asnjëherë nuk kanë qenë në kundërshtim me njëri tjetrin, mirëpo çdo herë kanë punuar për të mirën e shëndetësisë. Sa i përket

propozimit për dërgimin në dëgjim publik të Statutit të QKMF-së në një far mënyre në bazë të parimit dhe në bazë të rregullave është dashur të vijë projekt-statuti i Ministrisë së Shëndetësisë së bashku me Statutin të cilin e kemi aprovuar ne në Këshillin Drejtues me disa rekomandime apo ndryshime të vogla. Edhe unë kam qenë pjesëmarrës në atë Këshill Drejtues dhe votues i këtij Statuti, i cili sot ka ardhur ne formën që e keni para jush. Unë mendoj se projekt-statuti i Ministrisë së Shëndetësisë është dashur të vijë së bashku me Statutin të cilin ne e kemi marrë, në mënyrë që të diskutohet në Komitetin për Shëndetësi dhe po ashtu të ftohen edhe përfaqësues të QKMF-së, përfaqësues të Zyrës Ligjore dhe pastaj të dal në dëgjim publik.

Ylber Islami: Për një fushë specifike siç është shëndetësia, mjekësia është mungesë e madhe mosekzistimi i një mekanizëm të tillë siç është Komiteti për Shëndetësi i cili është shumë i domosdoshëm për arsye se aty do të shoshitëshin problemet e shumta të kësaj fushe. Unë për herë të parë po e dëgjoj sot pa dëgjuar asnjë informacion më herët se cila është gjendja sot. Për fat të mirë janë përfaqësuesit e partive të ndryshme që i kemi këtu, mirëpo asnjëherë në asnjë debat të mëhershëm nuk është diskutuar për këtë çështje dhe realisht unë as nuk e di se çka po ndodh. Shqetësimi i vetëm i pushtetit që doli këtu, është emërtimi i QKMF-së. Ka shumë probleme si: të organizimit, të funksionimit ligjor, profesional, transparencës, mënyra e përzgjedhjes të kuadrit, mënyra e përmirësimit të shërbimeve shëndetësore dhe prej gjithë këtyre doli emri. Ne si këshilltarë nuk i kemi ato vërejtje që i dhanë dy mjekët, Fazilja dhe Remi, nuk e kemi as anën procedurale dhe ligjore. Pasi që prej vitit 2015 nuk ka dal në shqyrtim ky Projekt-Statut unë mendoj se edhe në QKMF ka probleme të brendshme. Nëse dikush ka nevojë emergjente unë besoj se ato janë QMF-të. A ka politika të qarta shëndetësore Komuna e Fushë-Kosovës, cili është numri i pacientëve, cili është trajtimi, cili është punësimi? Disa pyetje i kam bërë më herët mirëpo kurrë s'kam marrë përgjigje sepse nuk kanë qenë personale. Si të flas për Statutin, të cilin në vitin 2015 e keni vendos në raft, na keni sjell dokumentacionin e pa kompletuar, Komiteti për Shëndetësi, komiteti joformal nuk ekziston në Komunën tonë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Komiteti i Shëndetësisë do ta marr versionin e statutit pasi të dalë në diskutim publik. Ky komitet do ta shqyrtojë atë para se të sillet në Kuvend dhe do t'i japin vërejtjet e tyre. Roli i komiteve është ky: asnjë dokumentacion nuk mund të vijë në Kuvend pa e shqyrtuar komiteti përkatës duke i dhënë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre. Por një gjë duhet ta dini, ky statut duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me statutin e Ministrisë së Shëndetësisë. Unë nuk e di pse ju po flisni për statut, kur ne i kemi doktorët këtu. Nëse ke ndonjë vërejtje mund ta jepni, sikur atë lidhur me punësimin e punëtorëve.

Ylber Islami: Puna jote është që të mos përfshihet si pikë e rendit të ditës nëse ajo pikë nuk është e kompletuar, pa ardhur edhe raporti i ministrisë dhe statuti. Gjendja e QKMF-së në Fushë Kosovë a është si pasojë e statutit, pasojë informale apo pasojë e menaxhimit?

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kush është që ta aprovojme në parim këtë statut? Mirëpo, të mos dorëzohet në Kuvendin Komunal për aprovim final pa pëlqimin e Komitetit për Shëndetësi i cili duhet të koordinohet me Këshillin Drejtues. Le të punojnë bashkë Këshilli Drejtues me Komitetin për Shëndetësi edhe le të na sjellin Statutin final i cili duhet të diskutohet në Kuvend, në shtator të këtij viti.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim në parim 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë'.

U votua me: katërmëdhjetë vota 'për'; asnjë 'kundër' dhe gjashtë 'abstenime', gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave, e aprovoi në parim për diskutim publik 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin në parim, 'Projekt-Statutin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare Dr. Fatmir Krasniqi në Fushë-Kosovë' dhe procedimin e tij për diskutim publik.

Pika e pestë (5) - Shqyrtimi i dytë i 'Planit të Veprimit për kthimin e qëndrueshëm për personat e zhvendosur 2017-2018'.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Këtë 'Plan të Veprimit' e kemi diskutuar në Kuvendin Komunal mirëpo ka mbetur deri tash për shkak të implikimit financiar të komunës. Kjo gjë tashmë është sqaruar dhe Komuna duhet të marr përgjegjësinë për mjetet financiare të cilat duhen për realizimin e këtij 'Plani të Veprimit për vitin 2017-2018'. Hap diskutimin.

Nazmi Kelmendi: Ne e dimë se ky plan i veprimit për persona të zhvendosur dhe zgjidhje të qëndrueshme është në kuadër të strategjisë të cilën e kemi aprovuar dhe kërkohet implementimi. Ne si të tillë e përkrahim që të implementohet në koordinim me Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit, Qeverinë e Republikës së Kosovës, donatorët eventual, duke i përfshirë edhe kostot financiare që na përkasin neve.

Ylber Islami: Drejtorja që do të duhej të ishte përgjegjëse për këtë çështje nuk e ka rrjetin e organizimit formal as profesional, prandaj ne nuk jemi të informuar asgjë për këtë problematikë. Ne nuk e dimë as kur kthehen, as çfarë fshati janë, as çfarë zone. Nëse ne në Kuvendin Komunal nuk informohemi më herët lidhur me 'pikat e rendit të ditës' të cilat duhet t'i votojmë, nuk i shtjellojmë problemet me të cilat ballafaqohen qytetarët, atëherë besoj që ne nuk kemi nevojë të vijmë këtu vetëm sa për të votuar, pasi që këtë gjë mund ta bëjmë edhe prej shtëpive tona. Ne duhet ta dimë çka po votojmë, kënd e përfshinë procesi i kthimit, a i përfshinë vetëm komunitetet apo edhe shqiptarët të cilët kanë shkuar në vitin 2014-2015, unë se kam idenë çka po ndodh.

Naser Graicevci: Unë edhe në mbledhjen e Komitetit për Politikë dhe Financa e kisha një kërkesë që për këtë plan ta dëgjojmë edhe mendimin e Komuniteteve. Besoj që do të ishte mirë ta kemi edhe mendimin e tyre, të shohim se çka mendojnë ata. Ne i kemi bashkëqytetarë mirëpo ata mendojnë më qartë pasi që ky problem i prek drejtpërdrejt dhe më bindëse do të ishte sikur ata të tregonin a janë të kënaqur apo jo me këtë plan.

Shefja e ZKKK-së: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ky 'Planit të Veprimit për kthimin e qëndrueshëm për personat e zhvendosur 2017-2018', është hartuar në bazë të Rregullores Nr. 02/2010, që e definon punën e zyrës tonë, procesin e kthimit të zhvendosurve, i cili realizohet në bashkëpunim ndërmjet Komunës dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, të interesuara për kthim janë 30 familje.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim për aprovim 'Planin e Veprimit për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur 2017-2018'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet e dy anëtarë.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës unanimisht e aprovon:

'Planin e veprimit për kthimin e qëndrueshëm të personave të zhvendosur 2017-2018'.

Pika e gjashtë (6) - Propozim për ndarjen e mjeteve financiare për mësimdhënës në Fushë-Kosovë.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për mësimdhënës në Fushë-Kosovë', ftoj Drejtorin e Arsimit që të na jap sqarime.

Drejtori i Arsimit: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Ajo që do t'ju them është realiteti dhe s'ka kurrfarë manipulimi apo prapavije. Ju e dini se Fushë-Kosova ka një rritje enorme të popullatës, konkretisht në këtë aspekt edhe të numrit të nxënësve. Vetëm sivjet kemi një rritje prej 340 nxënësve, po flas deri më 20 qershor, kur ka qenë afati i regjistrimit. Por ne e kemi edhe afatin e dytë, i cili është prej 25 gusht deri më 1 shtator, për të gjithë ata që s'kanë pasur mundësi të regjistrohen më herët. Unë frikësohem se ky numër do të rritet dhe mund të jetë 400. Do të thotë se 400 nxënës nënkuptojnë diku 12 paralele të reja, nëse e marrim numrin e paraleleve me 32 nxënës. Këtë kërkesë e kam bërë për arsye se ne si Kuvend është mirë ta kemi një vendim pavarësisht gjendjes së mëtutjeshme si do të shtjellohet. Kërkesa të ngjashme kam bërë edhe në Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Financave. Ne si Drejtori e Arsimit patëm planifikuar 10 vende për këtë vit shkollor, mirëpo nuk kemi pasur rishikim të buxhetit. Edhe sivjet të njëjtën gjë e kemi bërë, por e dini se ende nuk ka rishikim të buxhetit. Ne duhet ta zgjidhim këtë problem në mënyrë që viti i ardhshëm mos të na zë në një situatë shumë të rëndë, të cilën ne e kemi pasur edhe më herët në vitin 2009, kur nuk kemi arritur t'i paguajmë arsimtarët e rinj që i kemi marrë. Në bazë të ligjit kur ka nxënës ne jemi të obliguar të formojmë paralele. Çështja e pagesave është diçka tjetër por ne nuk mund ti lëmë nxënësit pa mësues. Vetë fakti se tash i kemi 10 paralele të reja kjo do të thotë se ne duhet ti marrim 10 arsimtarë të ri. Çështja e pagesave do të mbetet kompetencë e Ministrisë së Arsimit dhe Ministrisë së Financave të cilat unë i kam informuar me kohë. Fushë-Kosova e ka mesataren më të madhe për nxënës në klasa, ne e kemi 30 mesataren në nivel të Kosovës, ndërsa Prishtina e ka 28 e mos të flas për komuna tjera të cilat e kanë 25 e 22. Nga kontakti i fundit që kam pasur me sekretarin permanent të Ministrisë së Financave nuk mora ndonjë përgjigje konkrete. Nëse s'do të ketë rishikim, ai tha se do të jetë shumë e vështirë zgjidhja e kësaj pune. Prandaj e vetmja alternativë na mbetet neve si Kuvend që të bëjmë një zgjidhje ku të kemi mundësi.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Për shkak të mos reflektimit të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Arsimit ne duhet ta marrim një vendim. Megjithatë Drejtori duhet t'i mbaj kontaktet atje, në mënyrë që nëse ky vendim nuk kalon me rishikim edhe me buxhetin që kemi kërkuar për 10 arsimtarë, atëherë do të kërkojmë që të aprovohet për vitin 2018.

Naser Graicevci: Unë kam biseduar me Ministrin e Arsimit, z. Arsim Bajrami, i cili edhe një herë më ka sqaruar ato që i kam pas të ditura edhe më parë. Grantet qeveritare ndahen në proporcion me numër të banorëve në komunë. Institucionet publike të arsimit, shkollat e mesme, fillore, janë përgjegjësi e Komunës, mirëpo pagat vijnë prej qendrës. Ne e kemi thënë që nga mbledhja e parë e kësaj përbërje, që të mos punojmë në interes të askujt, sepse asnjëherë nuk e kemi vu interesin e partisë mbi interesin e qytetarëve. Nuk është qëllimi se a do të fitojmë një votë më shumë, qëllimi ynë është që këta qytetarë të jenë të kënaqur me shërbimet e Komunës. Ne kemi një fluks marramendës të të ardhurve në Fushë-Kosovë, i cili na ka vështirësuar jetën në të gjitha aspektet, jo vetëm në arsim, edhe në infrastrukturë edhe në qarkullim. E megjithatë mundësitë tona nga grantet qeveritare po mbeten të njëjta. Komuna nuk është marrë në mënyrë strukturore me këtë problem, nuk ka dëgjuar për regjistrimin e tyre, nuk kanë marrë masa për një plan të veprimit që kemi kërkuar të bëhet. Unë besoj që edhe ata 10 arsimtarë që ju i kërkon janë pak. Ne e shohim të arsyeshme të bëjmë veprime të logjikshme duke menduar edhe për atë që vjen nesër e jo vetëm ajo çka është sot. Një gjë të tillë nuk e ka bërë ekzekutivi, prandaj sot vijnë në një moment që të votojmë apo të mos votojmë për një çështje kaq jetike.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Kemi grantin e përgjithshëm edhe grantin specifik. Granti i përgjithshëm kryesisht bazohet në numrin e banorëve që jetojnë në atë komunë. Ndërsa grantet specifike janë për shëndetësi dhe për arsim që e kanë normën ose numrin e nxënësve. Ne kemi kërkuar që të rriten 10 norma, tek e fundit ne mund edhe të mos i aprovojmë. Mirëpo edhe nëse i aprovojmë ne i sjellim si vendim me qëllim që të bëjmë trysni në dy ministritë. Sepse, nëse ata nuk i përcjellin grantet specifike që duhet të ndahen për numër të nxënësve dhe numër të normave që janë në Fushë-Kosovë atëherë ne jemi të detyruar të bëjmë shkelje ligjore, si ato që u përmendën më herët, në keqmenaxhim të mjeteve financiare ose keqklasifikim, në mënyrë që t'i kompensojmë pagat e punëtorëve t'i marrim ato prej mallrave dhe shërbimeve, për shkak se nxënësit nuk mund t'i lëmë pa mësues.

Naser Graicevci: Ne nuk mund të veprojmë në baza ditore, për këtë edhe auditori na ka tërhequr vëmendjen, që strategjia zhvillimore e komunës nuk përputhet me planet operative, apo nuk konvertohet në plane operative. Kjo mungesë e veprimit strategjik të Komunës, si institucion publik, na sjell në situata të vështira, sikurse kjo në të cilën ndodhemi tani. Ne nuk jemi kundër ndërtimit të shkollës, por shkolla duhet të ndërtohet në vendin e duhur, në lokacionin të cilit i është bërë analiza. Ne nuk jemi as kundër rritjes së numrit të arsimtarëve, por kjo të bëhet sipas ligjit dhe rregulloreve në fuqi.

Ylberi Islami: Prej nga erdhi ky shqetësim i Drejtorëve dhe i pushtetit që kaq shpejtë të hapen këto vende të punës. Pse nuk jeni shqetësuar më herët! Këtë çështje e pata ngritur në vitin 2014, ku ju kam thënë se e kemi planin afatshkurtër dhe afatmesëm për ndërtimin e një shkolle. Dhe tash e keni filluar ndërtimin e shkollës brenda orëve, pa plan dhe pa dëgjim publik. Përcaktimi i prioritetëve bëhet më herët, çështja e rritjes së numrit të nxënësve ka ndodhë qysh më parë. Le të vijnë 50, 500 apo 5000 nxënës në Fushë-Kosovë sipas ligjit ne kemi të drejtë të mos i regjistrojmë ata nxënës sepse kjo është kompetencë e nivelit qendror. Detyra juaj është që ta njoftoni Ministrinë e Financave dhe Ministrinë e Arsimit. Nuk është përgjegjësi e Komunës së Fushë-Kosovës ta rris

fondin e as t'i shtoj klasat, ato bëhen në harmonizim me nevojat dhe me ligjet që janë në fuqi. Nëse qenka e drejtë elementare shkollimi a nuk qenka e drejtë elementare edhe uji i pijshëm! Besoj se çështja e ujit është përgjegjësi më e madhe pasi që i prek drejtpërdrejt banorët që janë këtu e jo banorët që vijnë sot, nesër apo pas një muaji dhe i shtojnë problemet tona. Nëse po u dashka të shtohen fondet dhe numri i punëtorëve në arsim pse nuk shtohen edhe në shëndetësi ku është shumëfishuar numri i pacientëve. Po të ishit shqetësuar për shkolla, ato nuk do të kishin qenë në një kaos të tillë profesional dhe organizativ. Unë këtë e shoh si nevojë për punësimin e njerëzve. Pse nuk shqetësohet Drejtori apo Kryetari edhe për banorët e Nakaradë, të cilët i përkasin komunës sonë, por shqetësohen për ata që vijnë prej Drenicës, prej Pejës, prej nga nuk vijnë këtu.

Drejtori i Arsimit: Në bazë të ligjit, nëse ka nxënës, ne si Drejtori e Arsimit jemi të obliguar që të formojmë paralele. Unë e thash edhe më herët çështja e mbulesës financiare është diçka tjetër, por ne nuk guxojmë t'i lëmë nxënësit pa mësues. Nuk ka këtu kurrfarë qëllimi për të punësuar njerëz. Unë kam insistuar te drejtorët që nxënësit të regjistrohen me ekstrakt të lindjes dhe me kontratë të banesës. Të jesh i bindur se të gjithë janë regjistruar në këtë mënyrë, por problemi është se kemi fluks të madh të banorëve të rinj dhe ne nuk mund dhe nuk kemi të drejtë t'ju themi atyre mos hyni në shkollë, sepse janë të regjistruar këtu. Me këtë fluks që e kemi ne edhe vitin e ardhshëm duhet ta nisim një shkollë deshëm apo s'deshëm. Në momentin kur ne e kemi një fluks kaq të madh në Fushë-Kosovë, Nakarada nuk diskutohet pasi që nxënësit po i bartim me autobus. Ne e kemi obligim të bëjmë një zgjidhje nëse atë nuk e bëjnë dy ministritë.

Nazmi Kelmendi: Këtë shqetësim e kemi në 10 vitet e fundit i cili vjen si pasojë e fluksit të ndërtimeve në Fushë-Kosovë. Pothuajse nuk ka mbledhje të Kuvendit që nuk jemi marrë me çështjen e arsimit por edhe problemeve të fushave tjera në përgjithësi. Mirëpo për mua është një shqetësim i madh neglizhenca e treguar nga ana e MASHT-it dhe MF-it. Ne e dimë problematikën që shkakton fluksi i nxënësve, tejkalimin e paraleleve prandaj ne nuk mund të fajësojmë vetëm drejtorin sepse ky problem është i përgjithshëm edhe i yni. Ne filluam punën për një aneks të shkollës 'Mihal Grameno' dhe krejt Fushë-Kosova dolën kundër në vend që të gëzohen. E kemi obligim ligjor që në kuadër të Kuvendit Komunal t'i orientojmë dhe t'ju dalim në ndihmë gjithë qytetarëve. Ne e përkrahim propozimin e Drejtorisë për Arsim dhe si Grup Parlamentar i LDK-së kërkojmë që ky propozim të aprovohet.

Ylber Islami: Në Komunën tonë ka nevoja tjera, nuk është përgjegjësi e jona që shtohet numri i nxënësve, është përgjegjësi e nivelit qendror, ligji e përcakton kështu. Ju po përpiqeni të manipuloni me ndjesinë e arsimit, rregullat janë të caktuara qartë. Përgjegjësi e Drejtorit dhe e Komunës, edhe e jona, është që të dalim bashkë me prind dhe të organizojmë protestë një ditore, dy ditore edhe një javë. Mirëpo këto punë duhet bërë më herët e jo kur të vjen momenti i fundit. Duhet bërë presion në ministri, sepse ajo duhet t'i caktojë fondet. Çdo cent që e merr dhe jep jashtë ligjshëm është jashtë ligjshëm. Ligji e përcakton që s'mund të barten mjetet prej një kodi në kodin tjetër sepse dalin dyshime edhe për manipulime edhe për punësim.

Pas sqarimeve, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës e qiti në votim 'Propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për mësimdhënës në Fushë-Kosovë'.

U votua me: trembëdhjetë (13) vota 'për', një 'kundër' dhe gjashtë abstenime, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm.

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës, me shumicë të votave e aprovoi 'Propozimin për ndarjen e mjeteve financiare për mësimdhënës në Fushë-Kosovë' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për lejimin e mjeteve financiare në shumë prej 55,560.00€, për dhjetë mësimdhënës në Komunën e Fushë-Kosovës.

Pika e shtatë (7) - Propozim për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: E kemi për shqyrtim 'Propozimin për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme'. Është një kërkesë që duhet të hapen procedurat për caktimin e lokacionit për varrezave në Miradi të Epërme. Është detyrë e Ekzekutivit të Komunës që t'i hap procedurat dhe të gjej formën se si do ta caktojë atë lokacion.

Milaim Berjani: Përshëndes të pranishmit në mbledhje. Një përshëndetje të veçantë për kryetarin Burim Berisha, i cili ka gjetur këtë mënyrë serioze për të ndihmuar banorët e këtij fshati. Ju njoftoj se me të vërtetë i kemi punët ngushtë dhe është e rendit që të na ndihmoni të gjithë.

Naser Graicevci: Kemi kërkesa prej banorëve të Miradisë së Epërme për caktimin e një lokacioni për varreza dhe ne jemi dakord me çfarëdo forme përmes së cilës do të mund të zgjidhej ky problem.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal: Ne do t'i hapim mundësitë ligjore në disa variante dhe banorët do ta zgjedhin cili opsion është më i mirë për ta.

Nazmi Kelmendi: Si grup parlamentar pajtohemi që të nisim procedurat për gjetjen e mundësive për zgjidhjen e këtij problemi. në mënyrë të qëndrueshme dhe të arsyeshme financiarisht, me ndërrim apo me kosto të tregut.

Ylber Islami: Duhet të kemi kujdes që mos t'i kthejnë vendimet qysh po i kthejnë kohëve të fundit. Duhet shikuar procedurat e shpronësimit si dhe a e lejon ligji që të jenë prona private. Përndryshe as që diskutohet për varreza, ato duhet të rregullohen, jo vetëm në fshatin Miradi e Epërme, mirëpo në secilin fshat.

Pasi që diskutime tjera nuk pati, Kryesuesi i Kuvendit të Komunës ftoi anëtarët e Kuvendit të Komunës që të votojnë për 'Propozimin për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme'.

U votua unanimisht nga të pranishmit, gjithsej njëzet anëtarë të pranishëm

Në bazë të votimit Kryesuesi i Kuvendit të Komunës konstatoi se Kuvendi i Komunës me unanimitet e aprovoi 'Propozimin për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme' dhe mori:

V E N D I M

Për aprovimin e propozimit për fillimin e procedurave për caktimin e lokacionit për varreza në fshatin Miradi e Epërme.

Pika e tetë (8)- Të ndryshme.

Aida Alimi: Një vërejtje në procesverbal. Kam kërkuar një raport financiar me shkrim, për të ditur se ku janë shpenzuar mjetet e Kuvendit, por nuk është shënuar në procesverbal si pyetje.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë personalisht do ta sjelli raportin ku janë të shënuara të gjitha shpenzimet. Mirëpo, ju e dini që ato janë shpenzime të pagave dhe mallra e shërbime.


Sabit Godeni: Para tre katër muajve kemi votuar që të shkojmë në shëtitje. Vendimi i Kuvendit ka qenë unanim, pse nuk është realizuar ky vendim.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës: Unë kam bërë përpjekje më herët, mirëpo nuk kam pasur mundësi të bëj asgjë pasi Ministria nuk na ka lejuar të shkojmë në formën të cilën kemi kërkuar ne. Nëse nuk bëhet rishikimi i buxhetit do të kemi probleme lidhur me realizimin e vendimit. Nuk do të kemi mundësi të shkojmë sepse planifikimi nuk na ka lejuar, që të shkojmë në formën të cilën kemi shkruar më herët.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës falënderoi të pranishmit për pjesëmarrje në mbledhje. Mbledhja përfundoi në orën 12.25 minuta.

Procesmbajtës

Hasan Gjyrevci



Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Dr.sc. Fadil Krasniqi

